

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
MAD shpk

KREU I
Pjesa e përgjithshme

Ky statut, akti i themelimit dhe ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar MAD shpk.

KREU II
Emri, Forma e Shoqërisë, Zyra Qëndrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin MAD shpk.
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma e Shoqërisë

Shoqëria tregtare MAD shpk ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qëndrore

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar MAD shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në Lagja Nr.4, Rruga Mitat Hoxha, Terminali i posagjereve,Porti Detar, Sarande , Shqipëri.
Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.



NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është ne fushen :

Dhenie me qera te makinave dhe mjeteve te ndryshme motorike.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është e pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare MAD shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë MAD shpk.

Ata mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

KREU III

Kapitali i Shoqërisë, Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Shoqërisë, Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë

NENI 8


Kapitali i Regjistruar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar MAD shpk është 2.500.000 (dymilion e peseqindmije) lekë, i formuar teresisht nga ortaku i vetem i saj. Ky kapital ndahet ne 1(nje) pjese.

NENI 9

Kontributet në pjesë të kapitalit të shoqërisë dhe kuotat

Kapitalin i regjistruar i shoqërisë ndahet në këtë mënyrë:



1. **Dashmir Spahiu** , i biri i , lindur ne Kukes, dhe banues ne adresën: Rruga Dhaskal Todri, Banesa Nr. 41, mbajtes i kartes se identitetit me numer personal H50407149E.
2. Kapitali i shoqërisë i regjistruar ne pronësi te Dashmir Spahiu është 1 (nje) kuote dhe zotërohen 100 (njqid) % prej tij

NENI 10

Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me kuotën e kapitalit që zotërojnë. Në rast se nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre do të mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen në kapital të këtyre të fundit.

NENI 11

Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë

Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me kuotën e kapitalit që zotërojnë, me përjashtim të rastit kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme është shprehur dhe vendosur ndryshe.


NENI 12

Kalimi i kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë

Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Në rast transferimi, mbi bazën e çfarëdo lloj titulli, qoftë në rast shitje, dhurimi apo çdo lloj transferimi, në kuptimin me të gjerë të termit, kuotat duhet t'u ofrohen në bazë të së drejtës së parablerjes ortakëve të tjerë, me të njëjtat kushte e me të njëjtin çmim qe i janë ofruar palës së tretë.

Në këtë rast ortaku që do të shesë u njofton ortakëve të tjerë çmimin e ofruar prej të tretit, duke u paraqitur edhe provën me shkrim të ofertës. Ortakët e tjerë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit duhet t'i komunikojnë ortakut i cili do të shesë kuotat dhe ortakëve të tjerë dëshirën e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes.



Në rast se ortakët e tjerë nuk do të përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej të drejtës së tyre të parablerjes.

Në rast se njëri prej ortakëve të cilit i bëhet oferta për të blerë sipas së drejtës së parablerjes, nuk dëshiron ta ushtrojë këtë të drejtë, ortakët e tjerë të cilët kanë përfituar e ushtruar tashmë të drejtën e tyre të parablerjes për pjesën e tyre, mund ta ripërdorin këtë të drejtë mbi të gjitha ose një pjesë të pjesëve të kapitalit të cilat i ishin ofruar sipas së drejtës së parablerjes ortakut që nuk dëshironte ta ushtronte atë.

Në rast se disa ortakë dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara sipas së drejtës së parablerjes së ortakut që nuk dëshironte ta ushtronte atë të drejtë, ndahen në pjesë të barabarta.

Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara mbi bazën e së drejtës së parablerjes ortakut që nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do t'i transferohen atij tërësisht ose në atë masë që ai synon të blejë. Për këtë qëllim, ortakët e interesuar që do të përdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'ia njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të shesë, brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve që prej marrjes së njoftimit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes.

Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura bëhen me shkrim.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme, Administratori

NENI 13

Organet e Shoqërisë

Organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**.

Organi ekzekutiv i shoqërisë është **Administratori**.

NENI 14


Asambleja e Përgjithshme, Thirrja e Asamblesë, Quorumi, Kompetencat

Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 3 (tre) muajve, nga mbyllja e vitit financiar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime, dhe të shprehë mendimin e tij, dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit të nenshkuar.

Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asambleshë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi.

Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asambleshë e Përgjithshme nga Administratori.



Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo moment nga Administratori ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në Asamblesë e Përgjithshme.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbahet në selinë e shoqërisë.

Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre rekomande ose e-mail e cila u dërgohet në adresën që rezulton nga libri i ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për mbledhjet e Asamblesë. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të konsiderohet e thirrur në mënyrë të rregullt edhe në rast se nuk janë respektuar formalitetet e parashikuara për thirrjen e mbledhjes, **por nëse është i pranishëm ose i përfaqësuar i gjithë kapitali i shoqërisë.**

Asambleja do të quhet e vlefshme që në mbledhjen e parë. Në rast se një nga ortakët paraqet një kërkesë për shtyrje për shkaqe të arsyeshme, ortakët e tjerë prezent me konsensus do të përcaktojnë datën kur do të mbahet mbledhja e ardhshme, fakt i cili do të pasqyrohet në procesverbal. Caktimi i kësaj date nuk përjashton detyrimin e personit që ka thirrur mbledhjen për të njoftuar ortakët që mungojnë, për datën e re të mbledhjes.

Të gjitha vendimet e asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbali, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.


Vendimet e marra nga asambleja duhet të nënshkruhen nga ortakët pjesëmarrës në mbledhje. Proceverbali i bashkangjitet lista e pjesëmarrësve, njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe vendimi përkatës.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar janë:

- ndryshimet ne statut
- emerimi e shkarkimi i likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit
- pjestimi i kuotave dhe anullimi i tyre
- shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- investimet
- vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

Keto vendime duhet të miratohen, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në atë vijuese, **me 3/4 (tre te katertat) e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje. Në këto raste mbledhja do të jetë e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave në Asamble.**

Për çështje të tjera të cilat nuk kërkojnë një shumicë të kualifikuar sic janë :



- përcaktimi i politikave tregtare
- emërimi dhe shkarkimi i administratorëve
- përcaktimin e shperblimit per likujdoret, ekspertet kontabel dhe administratorit
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Asambleja e Përgjithshme merr vendime, si në mbledhjen e parë dhe në atë vijuese, *me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës në mbledhje. Në këto raste mbledhja quhet e vlefshme kur merrin pjesë ortakët që zotërojnë 30% të numrit total të votave në asamble.*

Vendimet janë të detyrueshme për ortakët që nuk janë të pranishëm ose që nuk janë dakord, përveç së drejtës së tyre të kundërshtimit që ushtrohet në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime në lidhje me çështjet e mëposhtëme, por pa u kufizuar në to:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, shpërndarjen e fitimeve vjetore, mbulimin e humbjeve etj.

NENI 15

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator i cili emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i shoqërisë është z. Dashmir Spahiu i cili do të qëndrojë në këtë detyrë sipas afatit të caktuar me ligj me të drejtë rrimërimi dhe mund të shkarkohet nga Asambleja në çdo moment.

Administratori ka të gjitha kompetencat administrative të zakonshme dhe të jashtëzakonshme që bëjnë pjesë në objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që Ligji apo Statuti i jep Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshire delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë.



KREU V

Eksperti Kontabël, Viti Financiar, Bilanci Vjetor, Rezerva Ligjore, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 16

Eksperti kontabël

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një ekspertit kontabël të autorizuar, të emëruar për një periudhë 3 (tre) vjeçare (dhe i rizgjedhshëm) nga Shoqëria, **me 3/4 (tre të katertat) e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje**. Në këto raste mbledhja do të jetë e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave në Asamble.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjtën procedurë si ajo e emërimit.

NENI 17

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Bilancet vjetore, inventari, raporti i administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 18

Rezerva Ligjore

Shoqëria krijon fondin rezervë (rezervë ligjore) të saj.

Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

NENI 19

Fitimet

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kontributin e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Shoqëria mund të shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj,



- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë, Largimi dhe Përrjashtimi i Ortakëve

NENI 20

Riorganizimi i Shoqërisë

Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera, ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore. Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të marrë, nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar siç parashikohet në nenin 15 të këtij statuti.

NENI 21

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria nuk priset në rast humbje të zotësisë, vdekje ose gjendje falimentimi të ortakëve.

Në rast prishje shoqëria do të nënshtrohet procedurës së likuidimit.

Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22

Largimi dhe Përrjashtimi i Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim për largimin ose përrjashtimin nga shoqëria të një ortaku. Për largimin ose përrjashtimin e ortakut do të zbatohen dispozitat ligjore të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KREU VII

Dispozita të Fundit

NENI 23

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve zgjidhen me mirëkuptim.


Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë të drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 24

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Statut përpilohet me date 01/08/2023 në 2 kopje kopje origjinale secila me të njëjtën vlerë ligjore

**ORTAKU
DASHMIR SPAHIU**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Dashmir Spahi", written in a cursive style over the printed name.